

## Incidenca dhe prevalenca me kancer të mushkërive në Spitalin e Përgjithshëm të Gjakovës “Isa Grezda” gjatë periudhës kohore 2016-2018

Marku Gjergj<sup>1</sup>; Taganoviq Besarta<sup>1</sup>

Kolegji Heimerer<sup>1</sup>

**Hyrje:** Kanceri i mushkërive i njohur gjithashtu si karcinoma e mushkërive, është një tumor i mushkërive malinje karakterizuar nga rritja e pakontrolluar e qelizave në indet e mushkërive. Kjo rritje mund të përhapet përtej mushkërive nga procesi i metastazës në indet e afërta ose në pjesë të tjera të trupit. Faktorë të mundshëm të kancerit të mushkërive janë: duhanpirja, ekspozimi ndaj gazit të radinit (radiumit), ekspozimi ndaj asbesti, ndotja e ajrit, faktor gjenetik, ekspozimi ndaj radioterapisë, ekspozimi ndaj rrezatimit jonizuese. Kanceri i mushkërive lind nga qelizat në mushkëri që janë rritur në mënyrë jonormale dhe shumëfishohen për të formuar një grumbull ose tumor (Medical, 2019).

**Qëllimi** i këtij hulumtimi është që të nxirren të dhënat për incidencën dhe prevalencën e të diagnostikuareve me kancer të mushkërive në Spitalin e Përgjithshëm “Isa Grezda” në Gjakovë për periudhën kohore 2016-2018.

**Metodologjia:** Në këtë hulumtim është përdorur metoda retrospektive, kuantitative dhe parciale, që është realizuar përmes nxjerrjes së statistikave nga Spitali i Gjakovës. Shënimet në lidhje me të sëmuret me kancer të mushkërive janë marr nga protokollet e Drejtorisë së Spitalit (zyra për statistika) “Isa Grezda” - Gjakovë

**Rezultatet:** Sipas të dhënave të mbledhura në këtë hulumtim grup moshë më e prekur gjatë periudhës kohore 2016-2018 është mbi moshën 65 vjeçare ndërsa gjinia me e prekur është gjinia mashkullore. Incidenca për vitet 2016-2018 është 0.18, ndërsa prevalenca për vitet 2016- 2018 është 0.53.

**Konkluzionet:** Në bazë të analizave të të dhënave gjatë këtij hulumtimi u arrit në përfundim se numri i të diagnostikuareve nga kanceri i mushkërive është gjithnjë e në rritje dhe kjo mund të vë në pasojë e ndikimit të shumë faktorëve të tillë si faktorët gjenetik dhe të mjedisit ndikojnë në zhvillimin e sëmundjes së kancerit pulmonar. Ngritja e vetëdijes publike që të zvogëlohet pirja e duhanit në vende publike dhe gjithashtu kujdesi ndaj faktorëve të tjerë të rrezikut mund të zvogëlojnë incidencën e sëmundjes.

**Fjalët kyçe:** kanceri i mushkërive, incidenca, prevalanca.